

VENDIM
Nr. 719, datë 16.10.2012

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 532, DATË 7.7.2010 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR PJESEMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONE USHTARAKE NË SHTABE TË
NDRYSHME NË AFGANISTAN”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar dhe të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 532, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1.3, fjalët “... 31 gusht ...” zëvendësohen me “... 30 shtator ...”.

b) Pas pikës 1.6 shtohet pika 1.7 me këtë përmbajtje:

“1.7 Në Shtabin e Komandës Rajonale Perëndimore (RC-W), “ISAF”, Afganistan.

- Misioni: Mbështetje dhe dhënie kontributi në funksione të ndryshme në Shtabin e Komandës Rajonale Perëndimore, në operacionin ushtarak të NATO-s, “ISAF”, Herat, Afganistan.

- Numri i pjesëmarrësve, 3 (tre) ushtarakë.

- Kohëzgjatja deri në 2 (dy) vjet, afat, i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të kontingjentit në Afganistan. Kohëzgjatja për çdo rotacion është 6 (gjashtë) muaj, së cilës i shtohet edhe periudha e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës.

- Venddislokimi, Herat, Afganistan.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha